



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 175, Datë 26.10.2017

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SE SHOQËRISË
“HEC-i DRAGOSTUNJE” SH.P.K., PER LËNIEN PENG TË ASETEVE TË
LUAJTSHME DHE TË PALUAJTSHME QË DO TI PËRKASIN “HEC –I
DRAGOSTUNJE”, (ASETE QË DO TI SHËRBEJNË VEPRIMTARISË SË
LICENCUAR; NDËRTESA, PAJISJET DHE GJITHË SISTEMIN E PRODHIMIT
DHE SHPËRNDARJES), NË FAVOR TË BANKËS “SOCIETE GENERALE
ALBANIA” SH.A**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20 gërma “a” dhe 44, pika 1, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe në zbatim të neneve 6; 7 dhe 8 të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr.119, datë 21.07.2016.; pikave 1.3 dhe 1.6 të “Licencës për Prodhimin e Energjisë Elektrike” gjithashtu dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 26.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës se shoqërisë “HEC-i Dragostunje” sh.p.k., për lënien peng të aseteve të luajshme dhe të paluajshme që do ti përkasin “HEC –i Dragostunje”, (asete që do ti shërbejnë veprimtarisë së licencuar; ndërtesa, pajisjet dhe gjithë sistemin e prodhimit dhe shpërndarjes), në favor të bankës “Societe Generale Albania” sh.a , të përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “HEC-i DRAGOSTUNJE” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikura nga ERE në Rregulloren për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licensuarit si më poshtë:

- Neni 7 pika 1 gërmat: “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “g”, “j”, “k”, është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 7 pika 1 gërmat “d” (një përshkrim të kandidatit të propozuar për transferim aset, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që

përfshihet në transaksion të tre viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare;) dhe “h” (marrëveshje paraprake e nenshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e asetëve. Marrëveshja duhet të përmbajë një listë të detajuar të asetëve që kërkohet të transferohen); “i” deklaratë me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit;

- Nenin 7 pika 3. (Subjektet konçencionare të licencuar, të cilët aplikojnë për miratimin e transferimit të asetëve në ERE, duhet të shprehin në formë të shkruar në marrëveshjen e transferimit të asetëve, detyrimet me të cilat ngarkohen për shkak të marrëveshjes së konçensionit e pjesët që transferojnë tek përfituesi...), do të njoftohet subjekti që ti paraqesë në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hec-i Dragoshtunje” sh.p.k., për lënien peng të asetëve të luajtshme dhe të paluajtshme që do të përkasin “Hec –i Dragoshtunje”, (asete që do të shërbejnë veprimtarisë së licencuar; ndërtesa, pajisjet dhe gjithë sistemin e prodhimit dhe shpërndarjes) në favor të bankës “Societe Generale Albania” sh.a.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut do të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI